



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/102

Datë: 19.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja e 96 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/102

Datë: 19.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-199 për Gjykatat.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/102

Datë: 19.11.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2012, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë nr. 02/93 datë 04.10.2012**

1. Pas pikës 3 të Vendimit të Qeverisë Nr. 02/93 datë 04.10.2012, shtohen dy pika të reja me numrin rendor 4 dhe 5 me tekstin si në vijim:

“4. Rriten pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), në totalë në lartësi prej 40%, lartësia prej 26.25% e rritjes së këtij pensioni do tu paguhet shfrytëzuesve që nga data 1 janar 2012, ndërsa lartësia tjetër e rritjes së këtij pensioni do të paguhet nga data 1 janar 2013.”

“5. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të siguroj mjetet për këtë rritje të pensioneve brenda ndarjeve të saj buxhetore për vitin 2012 dhe vitet vijuese.

2. Pika 4 dhe 5 e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/93 datë 04.10.2012, rinumërohen si 6 dhe 7.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë